

## **Ndërprerja e studimeve, largimi**

- 1.** Studenti mund të ndërpresë studimet për një periudhë kohore jo më shumë se kohëzgjatja normale e programit përkatës të studimeve. Në këtë rast, ai duhet të bëjë një kërkesë pranë sekretarisë së njësive kryesore, në të cilën duhet të përcaktojë kohën e ndërprerjes së studimeve. Kërkesa e studentit protokollohet dhe depozitohet.
- 2.** Me rifillimin e studimeve, studentit duhet të shlyejë detyrimet e reja që lindin për shkak të ndryshimit të planit dhe programeve mësimore të lëndëve.
- 3.** Rifillimi i studimeve bëhet vetëm në fillim të vitit akademik dhe jo më vonë se dy javë nga fillimi i tij. Rifillimi ose ripranimi i studentit bëhet mbi bazën e një kërkesë dhe dokumentacionit të nevojshëm të dorëzuar prej tij në sekretarinë e njësive kryesore.
- 4.** Studenti mund të largohet nga universiteti, duke u çregjistruar përfundimisht. Për këtë ai bën një kërkesë me shkrim ku shpreh arsyet e largimit. Sekretaria e njësive kryesore, pranon kërkesën dhe ia paraqet drejtuesit të njësive kryesore për të marrë vendimin. Me marrjen e vendimit, sekretaria mësimore bën çregjistrimin e studentit, duke regjistruar në regjistrin themeltar datën e çregjistrimit dhe firmën e studentit. Çregjistrimi i studentit bëhet me vullnetin e tij të lirë (përveç rasteve të përjashtimit nga shkolla), në prani të studentit. Studenti tërheq dokumentat e tij personalisht ose mund të autorizojë me prokurë të posacme një person tjetër.